

---

## RAPORT NDERVEPRIMI ME MJEDISIN

### Projekti: "FERME PER RRRITJEN E SHPENDEVE 1 - KAT"



Dokumentacioni hartohet mbi baze ligjore:

- **Referuar VKM Nr 828 date 28.12.2023, per disa ndryshime dhe shtesa ne VKM Nr. 686, date: 29.7.2015, "Per miratimin e rregullave, te pergjegjesive e te afateve per zhvillimin e procedures se vleresimit te ndikimit ne mjedis dhe procedures se transferimit te vendimit e deklarates mjedisore"**
- Ligjit Nr. 12/2015 "Për disa ndryshime në ligjin nr. 10440, datë: 07.07.2011, "Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis"; *Shtojca I, klasifikohet si aktivitet qe i nenshtrohet Procedures se thelluar te Ndikimit ne Mjedis. Specifikisht klasifikohet ne: Shtojca I, pika 17. Instalime për mbarështimin intensiv të pulave ose derrave me mbi: a) 1000 krere per pulat qe rriten per mish*

**Investitor/Pronar: Armand Kuka & Najada Kuka**

**NUIS: L82811403M**

**Adm: Armand Kuka**

Vendodhja: Kurjan, Bashkia Roskovec

***Raporti I Nderveprimit me Mjedisin u pergatit nga Eksperti Mjedisit:***

***Ing. Ermelinda AGALLIU***

***NUIS: L73404408G***

## Permbledhje

- a) Një përshkrim i shkurtër i mbulesës bimore të sipërfaqes ku propozohet të zbatohet projekti, shoqëruar dhe me fotografi;
- b) Informacioni për praninë e burimeve ujore në sipërfaqen e kërkuar nga projekti dhe në afërsi të tij;
- c) Një identifikim i ndikimeve të mundshme negative në mjedis të projektit, përfshirë ndikimet në biodiversitet, ujë, tokë dhe ajër;
- d) Një përshkrim i shkurtër për shkarkimet e mundshme në mjedis, të tilla si: ujëra të ndotura, gaze dhe pluhur, zhurmë, vibrime, si dhe për prodhimin e mbetjeve;
- e) Informacioni për kohëzgjatjen e mundshme të ndikimeve negative të identifikuara;
- f) Të dhëna për shtrirjen e mundshme hapësinore të ndikimit negativ në mjedis që nënkupton distancën fizike nga vendndodhja e projektit dhe vlerat e ndikuara që përfshihen në të;
- g) Mundësinë e rehabilitimit të mjedisit të ndikuar dhe mundësinë e kthimit të mjedisit të ndikuar të sipërfaqes në gjendjen e mëparshme dhe kostot financiare të përafërta për rehabilitimin;
- h) Masat e mundshme për shmangien dhe zbutjen e ndikimeve negative në mjedis;
- i) Ndikimet e mundshme në mjedisin ndërkufitar (nëse projekti ka natyrë të tillë);
- j) Kopje të certifikatës së specialistit/ëve për vlerësimin e ndikimit në mjedis dhe auditimin mjedisor, që ka hartuar raportin paraprak të VNM-së.


## INFORMACION I PERGJITHSHEM

Nderveprimi me Mjedisin eshte bere me kerkese te z. Armand Kuka per projektin ne studim “Ferme per rritjen e shpendeve 1-kat”, projekt I cili ndodhet ne zonen kadastrale 2336, e ndodhur ne fshatin Kurjan, Bashkia Roskovec, e treguar si me poshte:



Zona ne te cilen eshte projektuar objekti ndodhet ne fshatin Kurjan, Bashkia Roskovec I cili propozohet te ndertoet per rritjen e zogjve me nje kapacitet prej 12000 krere zogj qe rriten per mish. Prona pozicionohet pergjate nje rruges rurale qe sherben per nevojat e fermereve dhe bizneseve te zones kryesisht biznese bujqesore. Prona ka nje siperfaqe totale disponibel prej 1870m<sup>2</sup>. Sipas Planit te Pergjithshem Vendor te Bashkise Roskovec miratuar me vendim te KKTse Nr.4, Dt. 10/06/2020, kjo zone i perket sistemit bujqesor.

Zona eshte e mireformuar me infrastrukture te plote rrugore, te rrjetit ujesjelles, kanalizimeve, elektrikut dhe telefonise. Njesia Strukturore e zones paraqitur si me poshte:





**a. Një përshkrim i shkurtër i mbulesës bimore të sipërfaqes ku propozohet të zbatohet projekti, shogëruar dhe me fotografi;**

**Biodiversiteti**


Rrethi i Fierit ka një sipërfaqe prej 620 km<sup>2</sup>, prej të cilës 20% është natyrore. Bashkia e Fierit kufizohet nga dy lumenj kryesor si Vjosa dhe Semani. Ajo gjithashtu ka dalje edhe në zonën bregdetare. Zonat natyrore, në të cilat përfshihen edhe pyjet e kullotat, së bashku me pasuritë ujore përbëjnë habitatin kryesor të florës e faunës në territorin e Bashkisë. Në Bashkinë e Fierit takojmë zona të tilla natyrore në të cilat vendosen shumëllojshmëria e llojeve të rralla dhe me rëndësi të veçantë. Përgjithësisht, këto zona i takojmë pranë zonave të mbrojtura natyrore, përgjatë lumenjve dhe përgjatë vijës bregdetare. Habitatin në zonën e Pishë-Poros, Parkun e Levanit, Dunat e Semanit, në Kurorën e vjetër të Lumit Seman në Fier dhe në zonën e pyllit të Cakranit është i larmishëm për nga ana floristike dhe faunistike. Në këto zona takohen bimësi psamofite, halofite, dhe hygrofite, pyje me pishë medhetare dhe me prani të kafshëve, si urithi, çakalli, nusja lalës, dhelpra, thëllëza, sorra e një sërë zvarranikësh. Numri i specieve floristike dhe faunistike që gjenden në Bashki dhe habitatet e tyre nuk njihet. Megjithatë, njihet përafërsisht numri i specieve në rrezik zhdukjeje (Libri i Kuq i Florës dhe Faunës Shqiptare, 2007) i cili shkon në 79 specie (rreth 10% e specieve në zhdukje në vend). Këto i përkasin kryesisht shpendëve, florës dhe insekteve.

**Flora**

Rrethi i Fierit ofron dhe potenciale të rëndësishme natyrore për zhvillimin e tij. Në përgjithësi kemi te bëjmë me një rajon fushor me lartësi nga 1–100 m mbi nivelin e detit dhe me toka shumë pjellore. Edhe relievet kodrinore janë përgjithësisht të buta dhe të mundshme për shfrytëzim bujqësor. Në zonat e rrafshëta zhvillohen tokat e hirta kafe. Kemi edhe lloje te veçanta tokash si aluvionale që takohen në luginat e Semanit e Vjosës, tokat e kripura që shtrihen në Hoxhare si dhe tokat moçalishte të Roskovecit. Në rrethin e Fierit shtrihet një pjesë e Myzeqese së Madhe, Myzeqeja e Vogël dhe fushat e Frakullës e të Cakranit. Bota natyrore bimore dhe shtazore e rrethit është transformuar nga veprimtaria e njeriut. Megjithatë rrethi i Fierit dallohet për disa lloje bimësh e kafshësh sidomos në pjesët bregdetare e fushore. Takohen disa lloje kafshësh si urithi, çakalli, nusja e lalës, dhelpra, shkurtëza, mëllenja, thëllëza e fushës si dhe disa lloje të ndryshëm zvarranikësh e gjarpërinjsh. Ndërsa në ujërat e detit gjenden shumë lloje peshqish si qefulli, levreku, koca etj. Rrethi i Fierit bën pjesë në brezin e shkurreve dhe të pyjeve mesdhetare. Shkurret përbëhen nga nënkati i makies, ku rriten shkurret me gjelbërim të përhershëm si mareja, shqopa, gjineshtra, dafina. Në këtë nënkat bimor rriten edhe disa drurë të lartë si selvia, valanidhi, pisha e butë dhe e egër, që në disa raste formojnë pyje të vegjël.

Nëntoka është mjaft e pasur me lëndë djegëse siç janë gazi natyror dhe nafta ku dallohet zona e Patos-Marinzës, e cila është dhe zona naftëmbajtëse më e madhe në Shqipëri. Gjithashtu nëntoka është e pasur edhe me materiale ndërtimi si zhavore, rërëra, argjila etj.

Rrethi i Fierit është një nga rrethet ku shoqëria njerëzore ka dëmtuar botën e gjallë me ndotjen mjaft të madhe të ajrit. Në të bëjnë pjesë disa zona te nxehta mjedisore si : fusha naftënxjerrëse Marinëz-Patos, Rafineria e Naftës Ballsh, Azotiku. Këto zona kanë sjellë ndotjen e dy lumenjve Gjanica dhe Seman, ujërave nëntokësore dhe në kombinim me automjetet e transportit, që çlirojnë një numër të madh gazrash, pluhuri dhe blozë, si dhe kanë bërë që Fieri të ketë një ajër tepër të ndotur mbi normat e lejuara. Një nga problemet kryesore është edhe eliminimi i 850 m<sup>3</sup> me tretësire arseniti dhe arsenati tepër helmues që ndodhen në Uzinën e Plehrave Azotike.



*Foto te bimesise ne pronen ne studim si dhe perreth saj*

### **POZICIONI GJEOGRAFIK I ZONES SE STUDIMIT**

Zona ne te cilen eshte projektuar objekti ndodhet ne fshatin Kurjan, Bashkia Roskovec. Ajo pozicionohet pergjate nje rruge rurale qe sherben per nevojat e fermerëve dhe bizneseve te zones. Prona ka nje siperfaqe totale disponibel prej 1840 m<sup>2</sup>. Sipas Planit te Pergjithshem Vendor te Bashkise Roskovec miratuar me vendim te KKTse Nr.4, Dt. 10/06/2020, kjo zone i perket sistemit bujqesor. Zona eshte e mireformuar me infrastrukture te plote rrugore, te rrjetit ujesjelles, kanalizimeve, dhe elektrikut.

Gjatë projektimit të këtij objekti janë marrë parasysh të gjitha rregullat urbane të përcaktuara në VKM në 408, duke respektuar të gjitha parametrat urban dhe duke mos cënuar privatësinë e komunitetit të kësaj zone.

Prona në të cilën propozohet të ndërtohet objekti “Ferme per rritjen e shpendeve 1-kat me funksion rritjen e zogjve deri ne masen e duhur per shitjen e tyre per mish ne kompani te licensuara per therrjen dhe tregtimin e tyre, prona ndodhet në zonën kadastrale 2336 me Nr. Pasurie 153/21, dhe ka një sipërfaqe totale 1870 m2. Sheshi i ndërtimit është i vendosur në një terren me pjerrësi të lehtë në buzë të rrugës rurale. Aktualisht kjo pronë është një hapësirë e pashfrytëzuar. Objekti i propozuar është projektuar duke ruajtur distancat nga pronat dhe objektet rreth tyre sipas ligjeve ne fuqi në të gjitha drejtimet.

- **Zona me rendesi te vecante:**


Roskoveci dhe zona përreth, është një qendër e banuar e hershme. Fakti që ndodhet ndërmjet dy qyteteve të hershëm, atij të Beratit dhe Bylisit, tregon që kjo trevë i përket një qytetërimi të hershëm. Siç dihet në afërsi të Roskovecit, ka qenë një nga kishat më të vjetra në Shqipëri, bëhet fjalë për kishën e Kurjanit. Nga dokumentet të studiuesve të huaj, një nga degëzimet e rrugës Egnatia, ka qenë me pikë fundore pikërisht në këtë zonë. Kjo shpjegon faktin tjetër të lindjes dhe funksionimit të njërit prej pazareve më të mëdhenj në vend, ai i quajtur Pazarit i Roskovecit, i cili shërbente jo vetëm për tregtimin e mallrave të gjithë zonës deri në thellësi të Skraparit, Beratit, Tepelenës etj. Mendohet gjithashtu, që në këtë pazar bëhej tregtia më e madhe e gurëve të çmuar dhe e materialeve prej argjendi në kohën e Perandorisë Osmane. Ky qytet ka gjithashtu një klimë shumë të mirë për zhvillimin e kulturave bujqësore e blegtorale. Roskoveci është shquar për rritjen e prodhimin e mishit të derrit. Roskoveci dhe zona përreth ka qenë qendër e banuar e hershme si një vendbanim i ndodhur ndërmjet dy prej qyteteve që i përkasin qytetërimit të lashtë (Berat dhe Bylis), si dhe pikë fundore e një prej degëzimeve të rrugës Egnatia.

Territori ne studim nuk eshte e perfshire ne menyre te drejtperdrejte ne zone te mbrojtur si:

- Rezerve strikte natyrore\ rezervat shkencor\ (Kategoria I);
- Park kombetar (Kategoria II);
- Monument natyror (Kategoria III);
- Rezervat natyror i menaxhuar\ zone e menaxhimit te habitateve dhe llojeve (Kategoria(IV));
- Peizazh i mbrojtur (Kategoria V);
- Zone e mbrojtur e burimeve te menaxhuara\ zone e mbrojtur me perdorim te shumefishte (Kat VI).

Me poshte ju paraqesim hartën e zonave te mbrojtura, ku duket qarte largësia qe ato kane nga prona ne studim.





*Harta e zonave te mbrojtura*

Territori ne studim ku do realizohet projekti nuk eshte i perfshire ne zone buferike, te cilat ruhen ne perputhje me legjislacionin perkates ne fuqi dhe as ne ndonje zone me vlera turistike apo zone te mbrojtur sic shihet edhe me siper, ku distancat e prones sone nga zonat e mbrojtura sipas legjislacionit ne fuqi po i paraqesim me poshte:

- 35 Km nga Zona e Mbrojtur Divjake-Karavasta;
- 35 Km nga Pisha Poro;
- 33 Km nga bregdeti Seman;
- 33 Km distance nga Vjose-Narte;
- 23 km nga rrënojat e qytetit antik te Apollonisë;
- 18 Km nga qendra e Fierit;
- 600 m nga qendra e fshatit Kurjan;

Pra sic duket edhe me siper nga distancat e paraqitura duhet te themi se prona jone ne studim nuk do te kete asnje efekt negative ne zonat me rendesi te vecante.

- **Ndikimet ne flore e faune:**

Territori ne studim ku do realizohet projekti “Ferme per rritjen e shpendeve 1-kat” nuk eshte i perfshire ne zone buferike, te cilat ruhen ne perputhje me legjislacionin perkates ne fuqi. Sic shihet edhe nga projekti, ne siperfaqen ku do te ngrihet objekti nuk ka fare gjelberim pasi kjo parcele ka qene e pashfrytezueshme sic edhe duket e ilustruar me siper aty ndodhen vetem barishte/shkurre pram und te themi se nuk do te kete ndikim ne Flore e Faune nga zhvillimi I ketij projekti.

- **Bimet endemike**

Rreth kesaj zone nuk ka bime te ndonje rendesie te vecante. Kjo zone duke qene nje zone kodrinore eshte e pershtateshme per bujqesi, e sic duket perreth jane mbjelle ullinj te cilet kultivohen nga pronaret e tokave perreth zones ne studim.

- **Klima**

Territori ku propozohet te vendoset objekti yne ne studim shtrihet ne zonen klimatike mesdhetare fushore. Regjimi klimatik i kesaj zone eshte tipik mesdhetar. Rajoni ne studim perfshihet ne zonen e klimes mesdhetare, e cila karakterizohet nga dimri i bute dhe i laget dhe vera e nxehte dhe teper e thate. Vecorite klimatike te zones jane kushtezuar kryesisht nga afersia dhe hapja e saj ne drejtim te detit Adriatik, por edhe nga lartesia e vogel e relievit dhe ngritja graduale e tij nga perendimi ne lindje. Karakteri mesdhetar i rreshjeve ben qe dimri dhe vjeshta te jene te lagesht, pranvera e paqendrueshme dhe vera e thate. Ato kane rregjim kohor shume te rregullt dhe jane perqendruar kryesisht ne gjysmen e ftohte te vitit. Numri i diteve me shi ne kete territor, varion nga 85 ne 100. Niveli i rreshjeve arrin 900 -1.200 mm ne vit. Muajt me te lagesht jane nentori dhe janari, kurse muajt me te thate korriku dhe gushti.

- **Temperatura**

Temperatura mesatare vjetore lekundet nga  $5.6^{\circ}\text{C}$  -  $16^{\circ}\text{C}$ . Afersia me detin ben qe klima te jete e bute, dhe vetem ne raste teper te rralla temperaturat te bien nen zero. Muaji me i ftohte eshte janari me temperature mesatare  $5.6^{\circ}\text{C}$  -  $7.5^{\circ}\text{C}$ , kurse me i ngrohti eshte korriku ose gushti me temperature mesatare  $24^{\circ}\text{C}$ . Numri iditeve me dieIIvariojne nga 263 ne 278, (mesatarisht 2800 ore ne vit). Ngricat dhe debora jane dukuri teper te rralla. I nxehti fillon qe prej mesit te pranveres dhe vazhdon deri ne fund te tetorit.

- **Era**

Ererat me karakteristike te ketij rajoni jane: jug-lindja, veri-perendimi dhe veriu. Ato fryjne ne drejtime te ndryshme, por gjate dimrit mbizoteron era e jugut, e cila sjell edhe rreshje te medha. Ndersa, gjate veres era fryn nga veriu dhe veri-perendimi. Sidoqofte, ne qarkun e Fierit mbizoteron reliev fushor-kodrinor dhe pergjithesisht mungojne ererat me drejtim gjithevjetore qe karakterizojne luginat e lumenjve ne terrene kodrinore-malore .

- **Sizmiciteti**

Trualli Shqiptar vendoset gjate kufirit te perplasjes se dy pllakave te medha qe levizin njera kunder tjetres; pllakes Euroaziatike dhe asaj Arabo-Afrikane, dhe eshte vater e perqendruar termetesh e cila preket me shpesh nga termete demtues.

Fieri eshte zone e prekur nga termetet, ku nga pikepamja sizmoteknike zona mund te goditet nga termete me magnitudo  $M_{max}=5.5-6.0$  grade Richter me intensitet deri ne 7 bale MKS-64. Por sipas studimeve Fieri nuk eshte nder qytetet ku termetet nuk kane patur pasoja te renda, por mund te kete pasur vetem demtime te vogla materiale. Pra nuk kemi termete me magnitudo te larte e cila mund te kthehet ne shqetesim per ceshtjet e zhvillimit dhe ndertimit te bizneseve afatgjate.

- **Gjeologjia dhe Terreni**

Roskoveci eshte njeh zoneh fushore. Qyteti ndodhet nje pjese ne njeh kodher te ulet, dhe pjese tjetere ne fushe. Ne veri te qytetit shtrihen fushat bujqesore te perfituara nga tharja e kenetes se dikurshme te Roskovecit. Roskoveci gjithashtu ka njeh liqen artificial.

Roskoveci dhe zona perreth, eshte njeh qender e banuar e hershme. Fakti qe ndodhet ndermjet dy qyteteve te hershem, atij te Beratit dhe Bylisit, tregon qe kjo treveh i perket njeh qyteterimi te hershem.



Siç dihet në afërsi të Roskovecit, ka qenë një nga kishat më të vjetra në Shqipëri, bëhet fjalë për kishën e Kurjanit. Nga dokumentet të studiuesve të huaj, një nga degëzimet e rrugës Egnatia, ka qenë me pikë fundore pikërisht në këtë zonë. Kjo shpjegon faktin tjetër të lindjes dhe funksionimit të njërit prej pazareve më të mëdhenj në vend, ai i quajtur Pazar i Roskovecit, i cili shërbente jo vetëm për tregtimin e mallrave të gjithë zonës deri në thellësi të Skraparit, Beratit, Tepelenës etj. Mendohet gjithashtu, që në këtë pazar bëhej tregtia më e madhe e gurëve të çmuar dhe e materialeve prej argjendi në kohën e Perandorisë Osmane. Ky qytet ka gjithashtu një klimë shumë të mirë për zhvillimin e kulturave bujqësore e blegtorale. Roskoveci është shquar për rritjen e prodhimin e mishit të derrit. Roskoveci dhe zona përreth ka qenë qendër e banuar e hershme si një vendbanim i ndodhur ndërmjet dy prej qyteteve që i përkasin qytetërimit të lashtë (Berat dhe Bylis), si dhe pikë fundore e një prej degëzimeve të rrugës Egnatia.

Bashkia e Roskovecit kufizohet në veri dhe perëndim me Bashkinë Lushnjë, në jug me Bashkinë Mallakastër, në lindje me Bashkinë Ura Vajgurore, ndërsa në perëndim me Bashkinë Patos.


Vargjet kodrinore me lartësi më të madhe (mbi 250 m) ndodhen në pjesën lindore, ndërsa ato me lartësi mesatare (100-150 m) ndodhet në të dy anët e rrugës Berat-Fier, ose anasjelltas dhe rruga me gjuhën popullore quhet “kufiri midis Myzeqesë dhe Mallakastrës”.

Referuar projektit arkitekturor, me poshte jepen te dhena teknike:

Treguesit e zhvillimit te propozuar:


Sipërfaqja e truallit që zhvillohet:	1870 m <sup>2</sup>
Sipërfaqja e truallit e zënë nga struktura:	301.4 m <sup>2</sup>
Sipërfaqja totale e ndërtimit mbi tokë:	301.4 m <sup>2</sup>
Sipërfaqja e tokës në përdorim të objektit:	506.3 m <sup>2</sup>
Koeficienti i shfrytëzimit të truallit:	16.1 %
Lartësia maksimale e strukturës:	5.5 m
Numri i kateve mbi tokë:	1
Numri i pasurisë:	153/21
Zona Kadastrale:	2336
Adresa:	Fshati Kurjan, Bashkia Roskovec

Parcela e cila do të përdoret për ndërtimin e objektit është një parcelë e pashfrytëzuar me parë, aty gjenden vetëm barishte apo shkurre sic duken nga fotot në terren. Pra pas ndërtimit të objektit për funksionin e përmendur me sipër do të bëjë të mundur zhvillimin e kësaj zone si dhe të ofrojë në treg produkte bujqësore me shumicë pasi ky sektor është i zhvilluar në këto zone e sidomos nga biznesi të cilit po i japin një rëndësi të vecantë zhvillimit të këtij rrethi.



*Harta Topografike e prones ne studim*





*Foto aktuale te prones ne studim*

Sic edhe duket nga fotot e kryera ne pronen ne studim, aty nuk kemi ndonje vegjetacion te zhvilluar por ndodhem vetem bimesi barishtoreje te cilat jane krijuar si rrjedhoje e mosperdorimit te tokes. Prona ne studim ndodhet ne ane te rruges rurale te fshatit dhe gjendet e rrethuar me toka te tjera bujqesore si dhe nga objekte me funksion bujqesor ne afersi te tij.

**b. Informacioni për praninë e burimeve ujore në sipërfaqen e kërkuar nga projekti dhe në afërsi të tij:**

Ne kuadrin e pasurive natyrore rëndësi të veçantë kanë pasuritë ujore, ku përveç detit Adriatik, rrethi përshkohet nga lumenjtë Seman, Vjosë e Gjanica.

Gjanica - 67 km buron nga burimet e Poçemit e të Kalivaçit. Sipërfaqja e pellgut ujëmbledhës është 234 km<sup>2</sup>. Është një nga lumenjtë më të ndotur në vend, për shkak të derdhjes së naftës. Rrethi ka edhe disa liqene artificiale ku më i madhi e më i rëndësishmi prej tyre është ai i Kurjanit me sipërfaqe 375 ha, ujërat e tij përdoren për ujitje.

Nëntoka është mjaft e pasur me lënde djegëse siç janë gazi natyror dhe nafta ku dallohet zona e Patos-Marinzës, e cila është dhe zona naftëmbajtëse më e madhe në Shqipëri. Gjithashtu nëntoka është e pasur edhe me materiale ndërtimi si zhavore, rërëra, argjila etj.

Ne afersi te prones tone nuk kemi burime ujore si lume, perrua, liqen etj, sic shihet edhe me poshte keto ndodhen shume larg prones sone ne studim.

Ne parcelat perreth kemi kanalet vaditese/kulluese te cilet jane ne gjendje funksionale per te cilet gjithashtu do te tregohet kujdes I vecante nga subjekti ndertues per te mirembajtur ato ne afresi te prones ku do te kryhet procesi I ndertimit.

Distancat e prones nga burimet ujore po I paraqesim me poshte:

- 7 km nga Diga Kurjan;
- 7 km nga ujëmbledhesi i Kurjanit



- 3 km nga Prroi Kurjan
- 200 nga prroi Pollotishtes



*Foto te burimeve ujore*

**c. Një identifikim i ndikimeve të mundshme negative në mjedis të projektit, përfshirë ndikimet në biodiversitet, ujë, tokë dhe ajër;**

Roskoveci është një qendër e vjetër, e banuar, e njohur fillimisht për një kohë të gjatë si "pazar". Ditët e djela aty grumbulloheshin shitës dhe blerës nga krahina të afërta dhe të largëta për të tregtuar mallra të ndryshme duke filluar nga gjeja e gjalle e deri tek produktet me të imetë bujqësore e artizanale. Për të shërbyer këtij pazari dhe njëzë të fshatrave përreth ishin ngritur dhe shumë dyqane zanatçinësh, kryesisht në rrugën që të çon në juglindje të qytetit (rruga për në Kurjan). Pjesa dermuese e zanatçinjeve dhe tregtareve të vendosur në qytet kishin ardhur nga Berati. Po ashtu qyteti kishte dhe një hotel ku strehoheshin pazarakët nga vendet e largëta por dhe udhëtarë të rastësishëm që leviznin midis Fierit dhe Beratit. Roskoveci u titullua "qytet" në vitin 1968, në bazë të kritereve të asaj kohe (Nëse kalohej një numër i caktuar qytetaresh që punonin në industri qendra e banuar bëhej "qytet")

Gjatë zhvillimit të aktivitetit nuk priten ndryshime të dukshme klimaterike, apo ndikime në popullsi si në drejtim të permiresimit ashtu edhe në atë të perkeqesimit të saj. Nuk do të ketë ndryshime në temperaturë, në drejtim të erës, në sasinë e reshjeve. Pra kryerja e këtij aktiviteti nuk ndikon fare në kushtet klimaterike të kësaj zone. Nuk do të ketë shprehje për arsye të ndërtimit të këtij projekti pasi prona është në pronësi të vet Investitorit si dhe kjo prone është e pashfrytëzueshme.

**✚ Ndikimet në ujë dhe tokë**

Duke qenë se projekti ndodhet larg burimeve ujore sipërfaqësore si rezervuar, perrua, liqen, lum, det etj, nuk kemi ndikime në ujë. Po kështu edhe për burimet nëntokësore ky aktivitet nuk përben rrezik, pasi ujerat nuk do të derdhen për asnjë arsye të patrajtuar dhe pa kriter në mjedisin përreth duke zbatuar me përpikëri projektin konstruktiv si dhe gjithë parametrat vendosur në të njëjtën mënyrë siç janë shprehur më poshtë:

Ne kete paragraf do te jepen fenomenet gjeodinamike qe e cenojne kete shesh dhe do te rekomandohen masat mbrojtese ndaj ketyre fenomeneve:

- Rekomandohet qe masat inxhinierike te marra, te monitorohen deri ne perfundim te ndertimit te themelit, nepermjet monitorimit topografik me pika fikse dhe/ose inklinometrave. Dherat e krijuar pas germimit te themelit, duhet te grumbullohen larg gropes se themelit.

- Themelet duhet te mbeshteten ne te njejten shtrese gjeologjike, dhe si menyre themelimi, mund te perdoret pllake betoni e armuar e mbeshtetur ne pilota. Para ndertimit te pllakes se betonit, duhet te shtrohet nje shtrese cakelli rreth 1.0-1.2m e cila duhet te ngjeshet mire, deri ne 98% te ngjeshjes laboratorike. Shtresat duhet te hidhen cdo 30 cm dhe cdo shtrese duhet te ngjeshet me vete. Menyra e themelimit duhet te varet nga llogaritjet perfundimtare te projektit.

Nga zhvillimi i aktivitetit nuk kemi humbje te tokes, rreshkitje te dherave, erosion etj. Asnje lloj mbetjeje nuk do shkarkohet ne toke pa u trajtuar me pare dhe pa kriter.

Mbetjet qe do te gjenerohen nga aktiviteti i pergjithshem i personelit apo ato te tipit ambalazh, shkon ne vendet e caktuara nga pushteti local (Bashkia Roskovec) dhe pjesa me e madhe (inertet nga procesi I hapjes se tokes per ndertimin e projektit do te perdoret per sistemimin e territorit rreth objektit pas fazes se ndertimit te tij dhe per kthimin ne tij ne gjendjen e meparshme por te permiresuar duke mbjelle peme apo fidane te llojeve te ndryshme.

- **Ndikimet ne mjedis gjate ndertimit te projektit te propozuar.**

Per ndertimin e ketij projekti do te kryen keto punime: germime, hapje themeli, instalim tubacionesh hidraulike dhe kanalizimi, mbushje te themelit, punime betoni, punime murature si dhe perdorim te makinerive teknologjike (betoniere) makina per transport materialesh, germuese dhe transportuese, etj. Pra gjate kryerjes se ketyre operacioneve do te kete krijim te pluhurave dhe zhurmave si rezultat i punimeve te ndryshme qe duhen bere ne te sipas projektit inxhinierik. Per te bere te mundur reduktimin ne minimum te pluhurave gjate transportit eshte e domosdoshme qe makina transportuese te lagen dhe te mbulohen ne menyre qe te mos kete asnje rrezik te derdhjes se tyre gjate transportit apo ngritjes se pluhurit.

- **Ndikimet ne mjedis gjate largimit te materialeve qe do te largohen nga kantieri, si dhera, inerte, linjat e tubacioneve te ujit etj, inertet nga prishja e objektit ekzistues**

Materialet qe do te largohen nga kantieri jane materiale inerte (dhera) qe do te vijne si pasoje e hapjes se themelit dhe pastrimin e terrenit per ndertimin e objektit te ri sipas projektit. Terreni neper te cilin do te kalojne kanalet dhe tubacionet e dergimit te ujit per ne objekt, tregon se kemi te bejme me germime minimale. Pjesa me e madhe e materialeve te germimit do te largohen nga kanalet, pasi do te perdoret material rere dhe zhavor per mbushjen e tyre. Megjithate nje sasi e vogel dheu i germuar do te largohet nga sheshi dhe duhet te depozitohet ne vende te caktuara nga pushteti vendor. Pikerisht pushteti vendor duhet te caktoj vendin e pershtatshem ku do te depozitohen pa shkaktuar ndotje ne mjedis. Pra gjate kesaj faze te kryerjes se procesit te punes per prishjen e objektit ekzistues si dhe germimet per hapjen e themelit do te kemi ndikime ne ajer si puhur, do te kemi clirim te zhurmes ne fazen e prishjes se objektit ekzistues, si dhe vibrim gjate procesit te hapjes se themelit. Keto ndikime do te jene te perkohshme ne kohe deri ne kryerjen e proceseve sipas raportit inxhinierik dhe planifikimit te proceseve te punes per te cilat subjekti ndertues se bashku me investitorin do te marre masat per zbutje te ndikimeve.

- **Ndikimet ne mjedis si rezultat i sjelljes se materialeve te ndryshme**

Megjithese kemi te bejme me ndertimin e nje projekti, nuk do te kemi volume te konsiderueshme materialesh ndertimi (rere, zhavor, tuba, etj.) qe do te sillen nepermjet makinave te tonazhit te larte, te mesem apo te vogel sipas rastit. Te gjitha keto makina do te rrisin trafikun dhe nivelin zhurmave. Eshte menduar qe punimet te kryhen ne orar te kufizuar nga ora 07.00-15.00 per te mos sjelle shqetesime ne ambientet perreth ne zbatim te procedurave dhe akteve ligjore ne fuqi.

- **Vleresimi i efektivitetit te pritshem te masave zbutese**

Realizimi i objektivave dhe treguesve te pritshem te parashikuar ne projektin e ndertimit, do te varet nga respektimi i treguesve te percaktuar ne kete raport. Kontrolli i monitorimit dhe permiresimi i vazhdueshem, sipas kushteve te shfrytezimit te krijuar gjate aktivitetit, do te coje perfundimisht ne perfitimin e pamjeve te parashikuara ne projekt. Masat zbutese te cilat do te zbatohen rigorozisht nga subjekti si dhe investitori do te mundesojne nje ambient me te paster, me pak te zhurshem duke perfituar nje projekt sipas standarteve ne respektim te gjithe legjislacionit ne fuqi.

- **Zhurmat**

Gjate ndertimit te projektit, do te kete angazhim te makinerive per kryerjen e proceseve si hapja e terrenit dhe pastrimi I tij si dhe fillimi I fazes se germimeve per themelin dhe proceset e ndertimit te projektit, si dhe largimi I tyre pas klasifikimit dhe ndarjes, germimi, montimi, transport materialesh, inertesh etj. Per te zbutur efektin e trafikut te ngarkuar dhe zhurmave qe shoqerojne ate, me qellim uljen e shqetesimeve per popullaten perreth zones se ndertimit, si rruge kantjerit do te perdoren rruget dytesore. Projekti nuk parashikon rruge ndihmese. Transportimi i materialeve te ndertimit ne rruget egzistuese do te programohet me kujdes per te shmangur cdo shqetesim ne trafikun lokal. Gjate dites ne kantier, automjetet e transportit te materialeve do te kerkohet qe te operojne me shpejtesi te ulta dhe do te ndaloher perdorimi i borive gjate transportit te materialeve qe do te vijne ne kantier.

- **Ndikimet ne ujrat siperfaqesore**

Zbatimi i ketij projekti nuk le shkas per ndotjen e ujerave te rrjedhes siperfaqesore nga ndotes te ndryshem si karburantet, apo lende te tjera ndotese. Nuk pritet te ndodhe ndonje ndotje nga shkarkimet ne toke, e me pas te shpelahen nga rreshjet, ndersa nga karburantet mund te kete vetem ndotje aksidentale nga rrjedhja e mjeteve te punes. Nuk kemi prani ne pronen ne studim te ujrave siperfaqesor sic jane, lum, liqen, det etj.

- **Ndikimet ne ujrat nentokesore**

Zbatimi i projektit nuk do te kete ndikim ne ujrat nentokesore, pasi germimet nuk do te jene te thella ndaj nuk do te kemi asnje lloj ndikimi negativ ne kete rast.

- **Ndikimet ne biodiversitet**

Sic shihet nga fotot e prones si dhe ortofoto duket qarte mungesa e biodiversitetit ne kete zone, asnje ndikim negativ nuk do te kete ne kete aspekt. Perkundrazi do te behet e mundur qe pas perfundimit te objektit gjate fazes se sistemim/rehabilitimit te pastrohhet e gjitha siperfaqe e lire ne te cilen pas objektit do te instalohen silloset dhe kaldaja si dhe do te kete terren te lire perreth objektit per cdo suate qe mund te ndodhe ne te ardhmen. Pemet frutore qe gjenden te mbjella ne afersi te kufirit te prones ne studim do te mbeten te paprekura gjate fazes se proceseve ndertimore.

- **Ndikimet ne toke**



Mbetjet qe do te gjenerohen nga aktiviteti i pergjithshem i personelit apo ato te tipit ambalazh ne fazen e shfrytezimit te objektit, shkon ne vendet e caktuara nga pushteti vendor. Gjate fazes se punimeve per hapjen dhe pastrimin e terrenit, largimin e te gjithë inerteve qe do te krijohen per hapjen e themeleve per ndertimin e objektit etj, nje pjese e tyre do te riperdoret per sistemimin e territorit rreth objektit per mbushje themelesh si dhe sistemimin pas fazes se ndertimit te projektit, dhe per transformimin e tij ne gjendje te permiresuar, duke ndryshuar pronen ne teresi dhe duke e kthyer ate ne prone te shfrytezueshme per qellimin e biznesit te produkteve bujqesore te zones duke I tregetuar ato, e keshtu edhe fermeret e kesaj zone do te kene me shume pune e rrjedhimisht me shume te ardhura. Pjesa tjeter e dherave do te depozitohen nga kompani e licensuar ne vend depozitim e percaktuar nga pushteti vendor.

Ne fazen e shfrytezimit te ketij objekti do te kete vetem mbetje urbane qe vijne nga banoret e ketij objekti te cilat do te depozitohen ne koshat e vendosur jashte objektit.

Ujrat e zeza dhe ato gri shkojne ne kanalizimet e zones te cilat jane ekzistuese ne kete zone ndaj nuk do te kemi ndotje te tokes per keto lloj mbetjesh.

- **Ndikimet ne ajer**

Punimet për ndërtimin e projektit do të nisin me hapjen e terrenit si dhe me sjelljen e materialeve te ndertimit ne kantierin ku do te punohet ndaj per kete arsye mund te kemi pluhura qe mund te shkarkohen ne ajer te cilat do te jene vetem ne fazen e pare te procesit te punimeve. Si çdo projekt i thjeshtë ndërtimor edhe ndërtimi i këtij projekti do të shoqërohet me ndikime në ajër, të tipit;

- Pluhurat/grimcat e ngurta, të cilat do të shkaktohen nga dherat të cilat do të gjenerohen në sheshin e ndërtimit si dhe inertet qe do te krijohen nga hapja e themeleve per te bere te mundur ndertimin e projektit te ri te propozuar. Përhapja e pluhurave do të evidentohet në ditë e thata dhe me erë;
- Gazet nga djegia e lëndës djegëse të mjeteve të punës;

Këto ndikime në ajër janë ndikime të pritshme të cilat do të jenë prezente thujase jatë gjithë fazës së ndërtimit të objektit sipas projektit te propozuar, janë ndikime të pashmangëshme por me aplikimin e masave zbutese mund të kontrollohen dhe menaxhohen si dhe do te jene ndikime te perkoheshme.

Ndotësit e shpërndarë që lëshohen në ajër, përfshijnë dhe grimcat (PM<sub>10</sub>). Megjithëse shkarkimet e transportit përgjithësisht referohen si burime “të shpërndara”, për shkak të lëvizjes së automjeteve, shumica e shkarkimeve nga sektori i transportit janë nga burimet pikësore (shkarkimet e automjeteve), me një sasi të vogël nga avullimi i naftës / gazit dhe rrjedhjeve, ne zbatim te Ligjit nr. 162/2014, datë 4.12.2014 “Për mbrojtjen e cilësisë së ajrit në mjedis”; dhe VKM-së nr. 352, datë 29.4.2015 “Për vlerësimin e cilësisë së ajrit të mjedisit dhe kërkesat për disa ndotës në lidhje me të”.

Probabiliteti që projekti në fjalë të shkaktojë impakte mbi cilësinë e ajrit dhe zhurmat, është i ulët, ndërkohë që edhe vetë impaktet janë në një shkallë të ulët, afatshkurtra dhe të kthyeshme. Infrastruktura ndikon direkt në uljen e cilësisë së ajrit dhe rritjen e nivelit të zhurmave, prandaj impaktet janë primare dhe njëkohësisht kumulative.

Ndërsa ne kantierin ku do te ndertohet objekti do te perdoret sperkatja me uje here pas here per eliminimin e perhapjes/ngritjes se pluhurit, si dhe do te kryhen monitorimet gjate fazes se ndertimit te projektit sipas percaktimeve te vendimit te VNM-se duke respektuar normat sipas legjislacionit sipas tabelës me poshte:

<b>Ndotësi</b>	<b>Përqëndrimi</b>
Lënda grimcore (PM <sub>2.5</sub> )	20-25 µg/m <sup>3</sup>
PM <sub>10</sub>	50 µg/m <sup>3</sup> 40 µg/m <sup>3</sup>

Pas perfundimit te projektit nuk do te kete asnje ndikim negativ ne ajer apo ne mjedisin perreth prones ne studim.

**d. Një përshkrim i shkurtër për shkarkimet e mundshme në mjedis, të tilla si: ujëra të ndotura, gaze dhe pluhur, zhurmë, vibrime, si dhe për prodhimin e mbetjeve;**

Ligjit nr. 10463, datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” i ndryshuar;  
Ne baze te ketij ligji subjekti ndertues si dhe investitori vihen ne dijeni te ketij ligji duke marre gjithë pergjegjesite ligjore qe u takojne ne rast te moszbatimit te tij.

Përcaktimi i përparësive në ligje, strategji, plane dhe programe të menaxhimit të integruar të mbetjeve të trashëguara apo të atyre që krijohen bëhet duke pasur parasysh hierarkinë e mëposhtme:

- parandalimin e mbetjeve;
- përgatitjen për ripërdorim;
- riciklimin;
- rikuperime të tjera;
- asgjësimin.

Mbetjet menaxhohen duke mos vënë në rrezik shëndetin e njeriut, duke mos përdorur procese ose metoda që mund ta dëmtojnë atë ose mjedisin dhe sidomos:

- a) duke mos vënë në rrezik ujërat, ajrin, tokën, tokën bujqësore, bimët ose kafshët;
- b) duke mos ndikuar negativisht mbi fshatin ose vendet me interes të veçantë;
- c) duke mos shkaktuar shqetësime përmes zhurmave ose erërave, në përputhje me përcaktimet e akteve të tjera ligjore apo nënligjore.

Nuk do te kemi nje trajtim te mbetjeve pasi do te kemi vetem dhera qe do dalin gjate procesit te germimeve te cilat nuk jane te demshme per ambientin perreth dhe sic e permendem me siper keto dhera do te riperdoren po ne pronen e investitorit per sasine e nevojshme dhe pjesa e mbetur e tyre do te transportohen ne vendet e percaktuara nga pushteti vendor. Nuk do te kemi mbetje te rrezikshme gjate fazes se ndertimit te ketij projekti dhe as ne fazen e shfrytezimit, ndaj nuk do te lind nevoja per asgjesim te mbetjeve pasi ato nuk hyjne ne kete kategori. Ndersa persa I perket mbetjeve te tipit urban do te largohen nga prona me makine te posacme dhe do te depozitohen ne vendet e percaktuara nga pushteti vendor sipas legjislacionit ne fuqi per transferimin e mbetjeve jo te rrezikshme.

Referuar Ligjit 10463 date 22.9.2011, Neni 5 “Mbrojtja e shëndetit të njeriut dhe mjedisit” si pjese e rendesishme e ketij projekti ku do te jete perparesi edukimi I personelit dhe zbatimi nga subjekti ndertues se bashku me investitorin i te gjithë kushteve te vendosur ne VNM paraprake si dhe ne Lejen e Ndertimit pas miratimit te saj nga Bashkia Roskovec e megjithate do te kemi gjithmone ne vemendje percaktimet ligjore.

Mbetjet do te menaxhohen duke mos vënë në rrezik shëndetin e njeriut, duke mos përdorur procese ose metoda që mund ta dëmtojnë atë ose mjedisin dhe sidomos:

- Duke mos vënë në rrezik ujërat, ajrin, tokën, tokën bujqësore, bimët ose kafshët;
- Duke mos ndikuar negativisht mbi fshatin ose vendet me interes të veçantë;
- Duke mos shkaktuar shqetësime përmes zhurmave ose erërave, në përputhje me përcaktimet e akteve të tjera ligjore apo nënligjore.

Ky raport hartohet mbi bazen e parimit te mbrojtjes se mjedisit dhe ne funksion te institucioneve vendim-marrese per licensimin ose jo te aktiviteteve te ndryshme te cilat mund te kene ndikim ne mjedis.

Me mbrojtje te mjedisit do te kuptojme veprimtarite te cilat zhvillohen duke pasur parasysh parimet baze te mbrojtjes se mjedisit te cilat jane:

- Parimet e mbrojtjes se mjedisit
- Parimi i zhvillimit te qendrueshem
- Parimi i parandalimit dhe marrja e masave paraprake
- Parimi i ruajtjes se burimeve natyrore
- Parimi i zevendesimit dhe/ose kompensimit
- Parimi i qasjes se integruar
- Parimi i pergjegjesise se ndersjelle dhe bashkepunimit
- Parimi "Ndotesi paguan"
- Parimi i se drejtes per informim dhe i pjesemarrjes se publikut
- Parimi i nxitjes se veprimtarive per mbrojtjen e mjedisit

Mbrojtja e mjedisit nenkupton mbrotjen e integruar te perberesve te mjedisit nga ndotja, si vecmas, ashtu dhe ne kombinim, duke pasur parasysh nderveprimet ndermjet tyre dhe qysh ne fazen e planifikimit te zhvillimit te nje territori te caktuar.

- Mbrojtja e Perbersve te mjedisit klasifikohet ne:
- Mbrojtja e ajrit
- Mbrojtja e ujerave
- Mbrojtja e tokes
- Mbrojtja e natyres
- Ndryshimet klimatike

Instalimi dhe funksionimi i aktivitetit, gjeneron mbetje sidomos gjate fazes se ndertimit. Investitori ne bashkepunim me expertin e mjedisit, do te marre masa per menaxhimin e mbetjeve qe do te gjenerohen, duke minimizuar gati ne eliminim efektet negative ne mjedis. Per kete do te investohet duke blere paisje bashkekohore qe do t'i vijne ne ndihme planit te menaxhimit te mbetjeve. Ato do te montohen ne kompleks gjate fazes ndertimore per te bere te mundur grumbullimin e mbetjeve ne vende te ndara sipas perberjes se tyre. Gjithashtu prona do te rrethohet para fillimit te punimeve per te lejuar punonjesit te punojne me qete dhe do te zbatohen kushtet e sigurise ne pune duke ruajtur edhe sigurine e kalimtareve, mjeteve te ndryshme te transportit si dhe automjeteve.

#### ❖ **Shkarkime te mundeshme si ujra te ndotur**

Gjate fazes se punimeve nuk do te kemi ujra te ndotur qe derdhen ne toke, uji per proceset e punes do te sigurohet me autobot uji per procesin gjate fazes ndertimore, per sperkatje te terrenit per eliminimin e emetimit te pluhurave ne ajer, uji do te jete i paster qe do te merret nga boti i ujit.

#### ❖ **Shkarkime te mundeshme si gaze dhe pluhur**

Pluhurat/grimcat e ngurta, të cilat do të shkaktohen nga dherat të cilat do të gjenerohen në sheshin e ndërtimit gjate hapjes se terrenit per ndertimin e projektit si dhe pastrimit te terrenit nga inertet qe do te krijohen nga hapja e themeleve per te bere te mundur ndertimin e projektit te ri te propozuar. Përhapja e pluhurave do të evidentohet sidomos në ditë e thata dhe me erë.

Gazet nga djegia e lëndës djegëse të mjeteve të punës qe do te funizojne me materiale ndertimi ne kantier sipas projektit te propozuar.



Këto ndikime në ajër janë ndikime të pritshme të cilat do të jenë prezente thujase gjatë gjithë fazës së prishjes së objekteve ekzistuese si dhe ndërtimit të këtij projekti, e sidomos në fillimet e tij, janë ndikime të pashmangshme por me aplikimin e masave mund të kontrollohen dhe menaxhohen deri në minimizim të ndikimeve negative.

Sipas Ligjit nr. 162/2014 “Për mbrojtjen e cilësisë së ajrit në mjedis”, këto ndikime në ajër janë ndikime të pritshme të cilat do të jenë prezente thujase gjatë gjithë fazës së ndërtimit të objektit e sidomos në fillimet e tij, janë ndikime të pashmangshme por me aplikimin e masave mund të kontrollohen dhe menaxhohen deri në minimizim të ndikimeve negative.

- Përdorimi i kamionëve dhe automjeteve që emetojnë gaze nga djegia e karburantit brenda normave të lejuara (Udhëzimi Nr. 6527, datë 24.12.2004 “Mbi vlerat e lejueshme të elementëve ndotës të ajrit në mjedis gazet dhe zhurmat”).
- Gjatë fazës ndërtimore, mjediset e punës (zona e kantierit) të spërkatën me uje për të evituar përhapjen e pluhrave.
- Automjetet të kufizojnë shpejtësinë e qarkullimit, sidomos në rrugë të paasfaltura, të cilat janë burim për krijimin e pluhrave.
- Në rast defektesh në rrugë, automjeti të qëndrojnë në korsinë e duhur dhe të vendoset gjithë sinjalistika e duhur për të lajmëruar defektet.

Gjatë fazës së ndërtimit të respektohen oraret e lëvizjes së automjeteve në orët e para të mengjesit dhe drekës.

Duke patur parasysh këto ndikime me fillimin e punimeve të proceseve ndërtimore do të merren masa menjëherë për eliminimin e emetimit të pluhurit në ajër duke spërkatur terrenin me uje, sidomos në ditë të thata e me erë, duke lare gomat e makinave para daljes së tyre në rrugë për mosndotjen e saj si dhe eliminimin e pluhurit. Nuk do të ketë ndikim të këtij lloji në zonën përreth por vetëm në pronën në studim, pasi edhe proceset ndërtimore do të jenë të thjeshta dhe që nuk marrin shumë kohë në ndërtim.

#### ❖ **Zhurma dhe Vibrimet nga procesi i punës**

Zhurmat në procesin e punës vlerësohen të jenë të ulëta, pasi do të kemi të bëjmë me procese ndërtimi të thjeshta të cilat nuk krijojnë zhurmë që të mund të kthehet në bezdi. Investitori do të operojë gjatë orareve normale të punës për të shmangur zhurmat në oraret e papershtateshme siç e përmendëm edhe më sipër. Si thame më sipër, zhurmat në vendin e punës vlerësohen të jenë brenda vlerave të lejuara, pavarësisht kësaj, zhvilluesi duhet të sigurojë pajtueshmëri për zbatimin e masave të sigurisë për mbrojtjen e shëndetit të punonjësve në vendin e punës. Në përfundim vlerësojmë se ndikimet për shkak të rritjes së niveleve të zhurmës në këtë zonë janë dukshëm të ulëta dhe të lokalizuara. Duke qenë larg qendres së Kurjanit dhe gjithë zonave të tjera ku densiteti i banimit është më i lartë ku pozicionohet dhe projekti ynë nuk do të ketë ndikime negative në objekte apo banorë ndaj themi që nuk do të ketë ndikim negativ për shkak të zhurmave, ndërsa punonjësit në kantier do të përdorin kufje gjatë fazës së punimeve e sidomos kur këto procese mund të gjenerojnë zhurmë.

E megjithatë, në zbatim të ligjit për zhurmat **Nr.9774, datë 12.7.2007 “Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis”**, puna do të kryhet në oraret normale të punës ndaj nuk do të kemi bezdisje për shkak të zhurmave që mund të krijohen, ndërsa përse i përket punonjësve ata do të përdorin kufje gjatë proceseve të punës që mund të gjenerojnë zhurmë si dhe të gjitha mjetet e transportit, përpara hyrjes në kantier apo të futen në shërbim, i nënshtrohen kontrollit teknik, që verifikon edhe respektimin e niveleve kufi të zhurmës të paraqitura në tabelën më poshtë:

Mjedisi	Vlera kufi e zhurmës dB(A) Leq, T Ditë	Vlera kufi e zhurmës dB(A) Leq, T Mbrëmje
Automjete/kamiona ne hyrje te kantierit	55	45
Kantier ndertimi	55	45
Mjedisi urban me i afert me kantierin	55	45

Llojet e masave mbrojtëse nga zhurma zbatohen në lidhje të ngushtë me oraret kur lëshohet zhurma. Për këtë qëllim, 24 orët ndahen në këto orare të cilat do të zbatohen nga subjekti ndertues:

1. Dita zgjat 13 orë, prej orës 06:00 deri në orën 19:00;
2. Mbrëmja zgjat 4 orë, prej orës 19:00 deri në orën 23:00;
3. Nata zgjat 7 orë, prej orës 23:00 deri në orën 06:00;

Gjate fazes së punimeve subjekti ndertues do të monitorojë zhurmat që vijnë nga proceset e punës me një kompani të licensuar për matjen e nivelit të zhurmës të cilat do të dorëzohen AKM sipas legjislacionit në fuqi dhe përcaktimeve të vendimit të VNM-së Paraprake.

Gjate fazes së funksionimit të projektit nuk do të ketë zhurma që mund të gjenerohen nga funksioni I këtij projekti pasi mos pasja e një teknologjie të instaluar në objekt bën që zhurmat të mos jenë prezente gjatë kësaj faze.

Për aktivitetet e ndërtimit distance nga ku mund të përceptohet vibrimi është si vijon:

- Punimet gërmuese të tokës deri 20 - 100 m largësi.
- Kompaktesimi dhe ngjeshja me vibrim 10 – 15 m largësi.
- Levizja e kamioneve të rëndë, 5 deri 50 m brenda kantierit dhe deri në 2 km jashtë kantierit;

Duke patur parasysh këto distanca të vendodhjen e projektit tone nga objektet e tjera apo qendrat e banuara, nuk ka objekte që të jenë të ndikuara nga vibrimi, pasi sic shihet edhe nga ortofoto objektet e tjera ndodhen në një distance të konsiderueshme nga objekti i propozuar pasi prona në të cilën do të ndertohet është e konsiderueshme dhe larg qendrave të banuara.

#### ❖ **Prodhimi i mbetjeve (Mbetjet e ngurta)**

Gjate fazes së fillimit të punimeve me rrethimin e tokës, do të fillojë pastrimi i territorit, hapja e tokës për ndërtimin e projektit i cili do të jetë me konstrukcion beton/aeme për të vijuar me pas me ndjekjen e procedurave sipas projektit tekniko-inxhinierik me ndërtimin e tij. Të gjitha mbetjet e kësaj faze janë mbetje inerte të padëmshme për mjedisin të cilat nëse nuk do të riperdoren me pas në sistemin e territorit do të depozitohen në vendet e përcaktuara nga Bashkia Roskovec.

Mbetjet inerte do të menaxhohen në bashkëpunim me përfaqësues të Njesisë së Qeverisjes Vendore, **bazuar edhe në VKM Nr. 575, datë 24.06.2015, ‘Per menaxhimin e mbetjeve inerte’**. **Keto mbetje do të depozitohen në një zonë të caktuar nga Bashkia Roskovec.**

Mbetjet inerte do të largohen nga kantieri drejt zonës së përcaktuar nga pushteti vendor pas përfundimit të punimeve. Pra mbetjet inerte të cilat nuk do të duhen për ripërdorim në pronën ku do të zhvillohet projekti këto mbetje do të depozitohen në vendet e përcaktuara nga Bashkia Roskovec me mjete transporti që do të jenë të pajisur me license të tipit III, 2 B si detyrim I këtij ligji “Menyra e menaxhimit të

mbetjeve” dhe do te jene te mbuluara siper per ta bere te sigurt transportin e tyre dhe te mos krijoje ndotje ne mjedis gjate transportit te inerteve.

Nje pjese e tyre, kryesisht dhera te paster do te perdoren per mbushje te aneve te themeleve, per sistemimin e sheshit dhe siperfaqet e gjelberta qe do te krijohen rreth objektit pasi ky i fundit te kete perfunduar procesin ndertimor sipas Lejes Zhvillimore.

Ne aktivitetin qe shoqeria jone do te kryeje, gjenerohen keto lloj mbetje:

- Materiale ndertimore si llac, beton, gelqere, zhavorr, rera etj,
- Ambalazhe te ndryshme si thase ,leter te cimentos, thase plastik, arka te ndryshme ambalazhi, plastike e druri etj.
- Materiale metalike si, hekuri per konstruksionin e objektit etj.

Te gjitha sa me siper do te evadohen dhe do te transportohen per ne pikat e caktuara nga organet e pushtetit vendor, **sipas përcaktimeve të Vendimit Nr. 229, datë: 23.04.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullave për transferimin e mbetjeve jo të rrezikshme dhe të dokumentit të transferimit të mbetjeve jo të rrezikshme”.**

Sasia e mbetjeve inerte qe do te depozitohen ne vend-grumbullimin e percaktuar nga Bashkia Roskovec eshte e konsiderueshme, por si detyrim i Ligjit 10463 date 22.09.2011 “Per Menaxhimin e integruar te mbetjeve” te ndryshuar, si dhe sipas VKM Nr. 418 date 25.06.2014 “Per grumbullimin e diferencuar te mbetjeve ne burim” Investitori ne bashkepunim edhe me Bashkine Roskovec do te bejne grumbullimin e mbetjeve ne vendet e dedikuara si dhe te ndara sipas pikes II te kesaj VKM.

**Investitori do te operoje per te gjitha makinerite sipas ketij ligji qe do te jene te pajisur me license te tipit III, 2 B si detyrim I ketij ligji “Menyra e menaxhimit te mbetjeve”**

Nga zbatimi I ketij projekti per ndertimin e projektit te propozuar nuk do te gjenerohen mbetje te rrezikshme (vetem dhera dhe inerte) gjate procesit te ndertimit dhe as fazes se shfrytezimit te ketij projekti, pasi te gjitha materialet qe do te perdoren per ndertim apo materialet si mbetje inerte qe do te dalin nga germimi per hapjen e plintave jane te gjitha konform standarteve te lejuara te cilat nuk paraqesin rrezik per shendetin dhe mjedisin ne zonen ku do te kryhet ndertimi I ketij objekti.

- **Sipas VKM Nr.575, date 24.06.2015** “Per miratimin e kerkesave per menaxhimin e mbetjeve inerte” referuar pikave 10 dhe 11 investitori do te operoje I mbikqyrur edhe nga perfaqesues te Bashkise Roskovec, per ndjekjen dhe zbatimin e te gjitha procedurave sipas ketij ligji, dhe depozitimn e mbetjeve inerte nese do te kete, ne vendet e percaktuara nga Pushteti Vendor.
